



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201402523/2

Tiranë, \_\_\_.\_\_.2015

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit të tarifës së televizionit ndaj shtetasit B. J.*

Drejtuar: **OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**  
Administratorit, Z. Adrian ÇELA,  
**TIRANË**

I nderuar Z. Çela,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi **B. J.**, (me nr. kontrate 15118), në të cilën ankohet ndaj "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Fier, lidhur me faturimin e tarifës së televizionit.

Konkretisht, ankuesi pretendon se për periudhën janar 2013 - shtator 2013, padrejtësisht i është mbajtur tarifa e televizorit, kur ai gëzon statusin e invalidit të përhershëm të punës, por megjithëse ka kërkuar pranë zyrave të kujdesit ndaj klientit kthimin e kësaj shumë, mbajtur padrejtësisht, ajo nuk i kthehet.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e konsideruar të drejtë e të bazuar në ligj pretendimin e ankuesit ju parashtrohet sa vijon:

Referuar legjislacionit në fuqi "OSHEE" sh.a., është duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 29, datë 27.12.2011, "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin Nr. 1 datë 08.01.2009, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive", të ndryshuar", ku në pikën 2.1 të saj përcaktohet:

**"2.1 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, konsumatorët e mëposhtëm familjarë:**

**a) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të ndryshuar; ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit".**

**Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., në momentin e pagesës së faturës së energjisë elektrike, librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga tarifa. Nëpunësi i zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., mban një kopje të librezës, në të cilët vendoset shënimi "përjashtuar nga tarifa".**

Pra, sipas këtij udhëzimi, detyrimi i pagesës së tarifës së televizionit, për periudhën janar 2013 – shtator 2013, përbën një detyrim abuziv, për një shërbim për të cilën objekti i faturimit është i përjashtuar ligjërisht. Në këto kushte, në mënyrë të

menjëhershme, duhet të merren masat për ndërprerjen e faturimit, korrigjimin dhe vendosjen në vend të së drejtës së shkelur, për shtetasin B. J.

Në përfundim, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë vazhdimin e kësaj situatë, si shkak për cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, në bazë të Nenit 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË:**

*Marrjen e masave të menjëhershme, për anulimin e faturimit të tarifës së televizionit ndaj shtetasit B. J.*

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

**K O M I S I O N E R E**

**Etilda GJONAJ (SALIU)**